

BV AUTO SHPK

Lagjia Nr.15 , Rruga A.Goga , Durres

NIPT L81505509C

Kapital i shoqerise 100 000 leke

RAPORT ME MBYLLJEN E PROCESIT TE LIKUJDIMIT

Drejtuar: Asamblese Pergjithshme te shoqerise "Bv Auto" shpk, Durres

Ne ekzekutim te misionit qe m'u besua nga Vendimi i Asamblese Pergjithshme te shoqerise, per te kryer procesin e likujdimit te shoqerise "Bv Auto" shpk Durres, raportoj per sa me poshte :

Kalimi ne likujtim i shoqerise u miratua nga Vendimi date 28.09.2020 .

Detyra ime ka qene qe te kryeja e procesit te likujdimit te shoqerise sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Baza ligjore per kryerjen e procesit te likujtimit ka qene :

- a) Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " i ndryshuar.
- b) Ligji nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " i ndryshuar.

dhe formalitetet qe duhet te respektohen nga shoqerite tregetare ,dhe administratoret e tyre.

Baza dokumentare:

- Pasqyrat Financiare te shoqerise te dates 28.09.2020 ne momentin e kalimit ne procedure likujdimi dhe Pasqyrat Financiare te likujdimit te shoqerise te dates 28.02.2021 .

- Dokumentacioni themelor i krijimit te shoqerise.

- Situata financiare e marredhenieve me Drejtorine Rajonale Tatimore Durres, ku shoqeria e mesiperme eshte regjistruar me NIPT L81505509C ,si dhe veprimet kontabile te kryera deri hapjen e procesit te likujdimit.

Ne fillim te procesit te likujdimit pushuan funksionet organet e drejtimit te shoqerise dhe nuk u lejua nisja apo vazhdimi i veprimtarive te tjera.

U kerkua inventarizimi i vlerave aktive dhe pasive te shoqerise, i cili eshte kryer deri me daten 28.09.2020 gjate procesit te marrjes se detyres se likujdatorit. Pas kesaj date dhe deri ne perfundim te procesit, cdo levizje u evidentua ne llogarite perkatese te kontabilitetit te shoqerise me miratimin edhe te dy ortakeve te saj.

Gjate periudhes se likujdimit eshte kryer procedura e trajtimit te zerave te bilancit te shoqerise te hartuar sipas Ligjit Nr.25/2018 date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" , dhe jane kryer te gjitha deklarimet fiskale, pagesat perkatese per cdo detyrim ligjore, si dhe procedurat e kerkeses per

arketim ndaj detyrimeve qe kane institucionet shteterore. Pra aktiviteti ekonomik i shoqerise per periudhen e procesit likujdimit ka qene rikuperimi ose arkeimi i klientave si dhe shlyerja e detyrimeve ndaj te treteve qe shoqeria ka patur.

Gjate procedures se likujdimit jane bere dhe dy njoftimet perkatese per kreditorët e shoqerise ,sipas ligjit, respektivisht me shtresat tona date 29.09.2020 dhe 29.10.2020 protokolluar prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe te publikuara nga kjo c fundit.

Per te gjitha veprimet financiare te kryera deri me date 28.02.2021 , u perpiluan Pasqyrat Financiare te Likujdimit te Shoqerise. Duke patur parasysh qe ekziston nje teprice TVSH-je ne vleren 113852 leke, dhe duke patur parasysh qe ortaket e shoqerise pranuan qe keto kredi te mbyllen nga llogarite e tyre qe shoqeria ju detyrohet per financimet e veprimtarise. Nese me procedura te mevoneshme te ketij institucioni qe ka detyrim per ti kthyer shoqerise arrihet te behet rikuperimi atehere perfitimi kalon direkt tek ortaket e shoqerise.

Eshte vendosur qe pas ç'rregjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetare prane QKB, te mbyllen edhe llogarite bankare prane Union Bank, sipas procedurave perkatese bankare.

Meqenese **nuk ekziston asnje detyrim i shoqerise ndaj** te treteve dhe procedurat e ndjekura kane siguruar rregullshmeri per administrimin e veprimeve ne te gjitha fazat e ketij procesi , me lejoni qe procesin e likujdimit ta konsideroj te mbyllur. Cdo gje tjeter qe nuk eshte shprehur ne kete raport gjendet e shpjeguar ne Pasqyrat Financiare te Likujdimit te Shoqerise "BV AUTO" shpk, Durres.

Ne keto kushte propzroj:

1. Njoftimin e Qendres Kombetare te Biznesit dhe Drejtorine Rajonale Tatimore Durres per perfundimin e likujdimit te shoqerise "BV AUTO" shpk, Durres.
2. Heqjen e mandatit te likujdatorit z.Kol Haxhia.

Durres , me 28.02.2021

LIKUJDATORI

KOL HAXHIA


BV AUTO SHPK
NIPT : 181505503
L15 DURRES